



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KUKËSSH.A

Nr. _____, Prot.

Kukes , më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *STUDIM PROJEKTIM PER “RIKOSTRUKSIONI I LINJAVE EKSZISTUESE TEDERGIMIT TE UJESJELLESIT TE QYTETIT KUKES NGA TUNELI KOLESJAN-DEPOSHTIQEN, RIKONSTRUKSIONI I KAPTAZHIT DOMAJ, DEPO SHPERNDARESE TE FSHATIT BUSHAT DHE BICAJ”.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sherbime per projektim tubacionesh 71322200-3, Studime Inxhenerike 71335000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,678,845.00 (Katermbedhjetë milione e gjashtëqind e shtatedhjetë e tetemije e teteqind e dyzet e pese)Leke , pa TVSH ose 155,282.4(njeqind e pesedhjetë e pese mije e dyqind e tete dhjetete e dy pike kater)Euro pa Tvsh. (Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 23.06.2026, 1 euro = 94.53 All).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Kukes sha** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”te ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar : citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 9 të DST.

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar** duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, (i ndryshuar). *Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi:*Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 i ndryshuar, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2022, 2023 dhe 2024, që rezulton të jenë përmbullur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.*

Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2023, 2024 dhe 2025, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrjnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2023, 2024 dhe 2025. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor

për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", ku parashikohet se: "Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.". Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në punët e realizuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Punë të ngjashme për realizimin e një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP.,

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 5.b Projektim furnizim me uje/kolektore shkarkimi
- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 5.e Vepra te trajtimit te ujit
- 5.f Projekte vepra hidroteknike, galeri e tunele hidrulike, marrje uji, shkarkimi.
- 8.a Rivlime inxhinierike.
- 8.c Sisteme GIS.

- 8.d Bazamente gjeodezike
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogeologjike
- 10.e Kabina elektrike te rrjetit shperndares –linja te tensionit teu let –temesem

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.**(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”te ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”te ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PIKATE KATEGORISE	PERSHKRIMI PER KATEGORITE
Kat.3.PROJEKTUES KONSTRUKTOR	3.c2Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet	Bazuar ne termat e references projektuesikonstruktor do te jete I domosdoshem për projektimin e Veprave inxhinierike,ndërtimit dhe operimit te Impianteve.
Kat.4.PROJEKTUES INSTALATOR	4.cProjektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale. 4.f Sisteme kundra zjarrit	Bazuar ne termat e references projektuesiinstalator do te jete I domosdoshem për projektimin e sistemeve të automatizuar të impiantit, pajisjeve te monitoriit te alarmit,sisteme vete automatizuar, ndricimit rrugoretj.

5.PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE	5.b Projektim furnizim me uje /kolektore shkarkimi 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime 5.e Veprate trajtimi te ujit 5.f Projekte vepra hidroteknike,galeri e tunele hidraulike,marrje uji,shkarkimi.	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi vepra hidraulike do te jete I domosdoshem për projektimin e linjes se dergimit te furnizimit me uje,vepra te marrjes si dhe trajtimin e ujrave te shiut ne sistemimet e jashtme te impiantit.</i>
8.PROJEKTUES GJEODET	8.aRivelime inxhinierike. 8.c Sisteme GIS. 8.d Bazamente gjeodezike 8.e Projektim Fotogrametrik dhe hartografik	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi gjeodet do te jete I domosdoshem për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me rilevimin e kuotave gjeodezike, kordinative te linjes dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, pusetave te kontrollit ,pusetave te ajrimit, pusetave te shkarkimit,të jepet plani I piketimit dhe verifikimi paraprak në terre npër saktësinë e të dhënave për parafillimit të projektit të zbatimit .Bazamente gjeodezike , rilevime ne te gjitha shkallet , Projektim fotogrametrik ,hartografik e topografike etj.</i>

9.STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK-HIDROGJEOLOGJIK	9.e Studime e Projektme hidrogeologjike	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi gjeolog do te jete i domosdoshem për shërbime të kërkuara të lidhura kryesisht me Studimet hidrogeologjike,hartimi ne Relacionit hidrogeologjik,hartimin Preventivit dhe analiza te çmimeve Për të vlerësuar gjeologjinë për Ndërtimin e objektit inxhinierik Përpara fillimit te projektit te zbatimit,te shërbimeve të lidhura Kryesisht me projektimi ne Strukturave mbrojtese si membrana izoluese,vleresim te strukture gjeologjike,stabilitet te terrenit, Perdorimin e metodave gjeofizike per Vleresimin e nentokes etj</i>
10.PROJEKTI I IMPIANTEVE TE PRODHIMIT DHE SHPERNDARJESSE ENERGIJE ELEKTRIKE	e-Kabina elektriketë rrjetit shpërndarës-linja të tensionit Të ulët –të mesëm.	<i>Bazuar ne termat e references projektuesi elektrik do te jete I domosdoshem për rprojektimin e linja te shperndarjes se tensionit te ulet dhe te mesem ne godinen e impiantit etj.</i>

2.3.3Një punësim minimal i **10 (dhjetë)** personave, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës e vërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
2. Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit objekt prokurimi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin.Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë

kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staf të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

2.3.4. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 2 {një} Inxhinier Hidroteknik
- 2 {dy} Inxhinier Ndertimi
- 1 {një} Inxhinier Elektrik
- 1 {një} Inxhinier Mekanik
- 1 {një} Inxhinier Xheodet/Markshajder/Topograf.

Drejtuesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar pranë shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrje të koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “Për prokurim publik” të ndryshuar dhe nenin 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Për realizimin e këtij studimi projektimi objekti nevojitet një ekip inxhinierësh të udhëhequr nga: **Drejtuesi i Teknik** që ka detyra kryesore të lidhura kryesisht me drejtimin dhe koordinimin e ekipit të inxhinierëve të stafit, drejtimin e aktiviteteve kryesore për realizimin e shërbimeve, prodhimin e dokumentave kryesore si dhe raporteve që kërkojnë sipas Detyrës së Projektimit, si dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetin kontraktor. Profili i këtij pozicioni kërkohej të jetë

Projektues Inxhinier Hidroteknik pasi ky profil i përshtaten shërbimeve të kërkuara për projektimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Inxhinier Ndërtimi, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit të lidhura sidomos me llogaritjet inxhinierike të depos së ujit me volum të konsiderueshëm, pusetave të shkarkimit, pusetave të ajrimit, pusetave të kontrollit, apo kalimet e kanaleve. Gjithashtu nevojitet për kryerjen e llogaritjeve inxhinierike për përcaktimin e shtresave rrugore, pusetave të manovrimit, si dhe materialit që do të përdoret për mbushjen e kanaleve ku do të shtrohen linjat e ujësjellësit me qëllim sigurimin e aftësisë mbajtëse ..

Inxhinieri elektrik përfshijnë projektimin, instalimin, mirëmbajtjen dhe testimin e sistemeve elektrike. Këta profesionistë mbikëqyrin punimet në terren, hartojnë skemat, analizojnë defektet dhe sigurojnë që impiantet të përmbushin standardet e sigurisë dhe efikasitetit

Inxhinieri mekanik planifikon, projektton dhe mirëmban sisteme mekanike, makineri dhe pajisje industriale. Detyrat kryesore përfshijnë krijimin e projekteve me softuerë (CAD/CAM), mbikëqyrjen e prodhimit, programimin e mirëmbajtjes së linjave, dhe koordinimin e ekipeve teknike në kantiere ose impiante.

Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me rëlevimin e kuotave gjeodezike, kordinative të rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, depos së ujit, pusetave të kontrollit , pusetave të ajrimit, pusetave të shkarkimit , të jepet plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit.

2.3.5Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndihmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 1(nje)Inxhinier Ndërtimi
- 1(nje)Inxhinier Hidroteknik

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për

realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Inxhinier Ndërtimi, kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e strukturave beton-arme me/pa prani të ujit të lidhura sidomos me llogaritjet inxhinierike të depose ujit me volum të konsiderueshem, puseta të shkarkimit, puseta të ajrimit, puseta të kontrollit, apo kalimet e kanaleve. Gjithashtu nevojitet për kryerjen e llogaritjeve inxhinierike për përcaktimin e shtresave rrugore, pusata të manovrimit, si dhe materialit që do të përdoret për mbushjen e kanaleve ku do të shtrohen linjat e ujesjellesit me qëllim sigurimin e aftësisë mbajtëse.

Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike për dimensionimin e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë, bazuar në modelimin e sistemit si dhe llogaritjet hidraulike të tubacioneve të shpërndarjes, puseta të manovrimit, puseta të pikave të lidhjeve individuale, analizën e sistemit alternativën e përzgjedhur për të gjithë zonën e studimit, sipas kushteve teknike të projektimit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të kenë në Stafin e Shoqërisë Personel të kualifikuar/certifikuar si:

A}1(një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Përsigurinë në kantier", shoqëruar me kontratën individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 një punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë")

C}1 (një) punonjës specialist "Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certificate dhënë nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listat e shoqërisë për minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore {me kontratë pune} përgjatekohes së ekzekutimit të kontratës objekt prokurimi. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 një punonjës "Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin")

D} 1(një) punonjës me certifikatë "Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis" (VNM) të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikatë, si dhe të figurojë në listat e shoqërisë minimum për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist "Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis").

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit objekt prokurimi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin.Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staf të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

Argumentimi :"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është profesionisti i ngarkuar nga punëdhënësi për të identifikuar rreziqet, për të këshilluar mbi masat mbrojtëse dhe për të garantuar zbatimin e rregulloreve ligjore në mjediset e biznesit apo institucionit tuaj

Argumentimi :Eksperti Zjarifikës në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH) përfshijnë hartimin e projekteve të sigurisë, auditimin teknik, kryerjen e ekspertizave pas rënies së zjarrit dhe ofrimin e trajnimeve, sipas përcaktimeve ligjore në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: “Ekspert përndikimin e vlerësimit në mjedis” është i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimit i Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve të Detyrës së Projektimit.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të të cilit është parashikuar se:

“Eksperti certifikuari VNM-së” është personifik, i cili pajiset me certifikatën për katëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të enit 6 të këtij ligji është parashikuar se:

“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

- a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;*
- b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;*
- c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;*
- ç) përfundimit të arritur, të arsyetua nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;*
- d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si me poshtë:

- 1. Certifikatë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) ose ekuivalente: **Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.**
 - 2. Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 14001-2015** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e menaxhimit cilësisë së Mjedisit.**
 - 3. Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 45001-2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.**
 - 4. Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 50001:2018** (e vlefshme)/ose/ekuivalent **Për sistemin e Menaxhimit të Energjisë**
-

(Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit)

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Pë rprokurimin publik”, të ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standardt që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpërbushjen e plotë të kontratës.

Certifikata ISO përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar të këtij shërbimi dhe që i vlerëson këtë shërbim si të pranueshem për funksionin e kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Certifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

2.3.8 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

A} 1 (nje) Pajisje GPS

B} 1 (nje) Pajisje Total Station

C} 1 {nje} Dron Fotogrametrik

D} 1 {NJE} Paisje Droni dizajnuar per inspektim, monitorim, detektim i pajisur me Lidar.

Për të vërtetuar përbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Pajisje GPS se bashku me Pajisje Total Station, Dron Fotogrametrik si dhe Paisje Droni dizajnuar per inspektim, monitorim, detektim i pajisurme Lidarkerkohen per te kryer matjet topografike dhe rilevimet qe lidhen me pozicionimin e rrjetit te ujësjellës - kanalizimevekuotave gjeodezike, kordinative te rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, pusetave te kontrollit , pusetave te ajrimit, pusetave te shkarkimit , depove rregulluese, plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit.

Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhornuar.

➤ ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DST

➤ **Sqarim në lidhje me mosndarjen e procedurës në Lote:**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndannjë kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Autoriteti Kontraktor ka arritur në përfundimin se **ndarja në lote nuk është eknikisht dhe funksionalisht e përshtatshme**, për arsyet si më poshtë:

Objekti i prokurimit përbën një projekt inxhinierik të integruar dhe funksionalisht të pandashëm, i cili kërkon hartimin e një skeme të vetme dhe të koordinuar të furnizimit me ujë për zonat Bashkise Kukes, duke përfshirë vazhdimin e linjës së transmetimit, projektimin e rrjeteve shpërndarëse, integrimin me rrjetet ekzistuese, vlerësimin dhe projektimin e depove akumuluese, si dhe modelimin hidraulik të të gjithë sistemit në mënyrë të unifikuar. Nga detyra e projektimit rezulton se të gjithë këta elementë janë të ndërlidhur teknikisht dhe ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e njëri-tjetrit.

Ndarja e procedurës në lote sipas komponentëve të ndryshëm (linja transmetimi, rrjet shpërndarës, depo, modelim hidraulik, projekt zbatimi etj.) do të sillte rrezik të lartë për mungesë koherence teknike dhe metodologjike ndërmjet produkteve të hartuara nga operatorë ekonomikë të ndryshëm, duke krijuar papajtueshmëri në parametrat hidraulikë, llogaritjet teknike, variantet e propozuara të furnizimit dhe standardet e projektimit. Kjo do të cenonte drejtpërdrejt cilësinë dhe zbatueshmërinë e projektit final.

Gjithashtu, detyra e projektimit kërkon që projektuesi të paraqesë dy variante funksionale të skemës hidraulike, të realizojë analiza tekniko-ekonomike të integruara, modelim hidraulik të sistemit, studime topografike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe mjedisore, si dhe të garantojë përputhshmërinë ndërmjet të gjitha fazave të projektimit, nga analiza fillestare deri te projekti i zbatimit dhe preventivi përfundimtar. Për realizimin efektiv të këtyre elementeve kërkohet një qasje e centralizuar projektuese dhe përgjegjësi unike profesionale, e cila do të ishte e vështirë të garantohej në rast ndarjeje në lote.

Ndarja në lote do të sillte gjithashtu rritje të kompleksitetit administrativ dhe kontraktor, duke krijuar vështirës në koordinimin e kontratave, monitorimin e dorëzimeve sipas fazave të projektimit, administrimin e përgjegjësive teknike dhe harmonizimin e dokumentacionit final për miratim dhe oponencë teknike.

Për sa mësipër, Autoriteti Kontraktor vlerësonse mosndarja e procedurës në lote është objektivisht e justifikuar, proporcionale dhe në funksion të garantimit të cilësisë, integritetit teknik dhe realizimit eficient të projektit, pacenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke qenë se tregu i shërbimeve të projektimit mundëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të specializuar në një procedurë të vetme prokurimi.

Njesia e Prokurimit


